

AKTI I THEMELIMIT
PËR SHOQËRINË "WHITE HOUSE FUNERAL HOME" SHPK
FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Tiranë në datën 19 qershor 2023 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "**WHITE HOUSE FUNERAL HOME**" shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

1. ADI BALLA, i biri Abedin, i datëlindjes 03/05/1986 lindur Tirane dhe banues ne Tirane, Rruga "Shemsi Haka", madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr personal I60503048V.

SELIA E SHOQERISE

1. Shoqëria tregtare "WHITE HOUSE FUNERAL HOME" SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tiranës, Njesia Bashkiake nr. 1, rruga Ali Shefqeti, zk. 8170, Ndertese dy kateshe, nr. pasurie 9/242 me vendim të ortakëve të shoqërisë, mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria Tregtare "WHITE HOUSE FUNERAL HOME" SHPK., do të përbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 600,000 lekë (gjashtëqind mijë lekë), i cili është tërësisht kapital financiar . Kapitali themeltar është i ndare në një kuote me vlerë nominale 600,000 lekë (gjashtëqind mijë lekë),

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. **ADI BALLA**, zotërues i një kuote apo 100 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë 600,000 lekë (gjashtëqind mijë lekë)leke.

Kapitali fillestari nuk është paguar.



OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “WHITE HOUSE FUNERAL HOME” shpk do të jetë :

Sherbime pritje-percjellje, ambjent me qira ditore per evenete dhe organizime mortore. Sherbim parkimi automjetesh. Te tjera aktivitete qe nuk jane te ndaluara me ligj.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqeria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj duke bërë ndryshimet përkatese në statut.

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1.Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :

- a- për ndryshime në statut
- b-emërimin dhe shkarkimin e administratorit
- c-miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.
- d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- e-riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Administratori i përgjithshëm i shoqërise , është **ADI BALLA** me afat 5 vjeçar me te drejtë ripërtëritje.

BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin ”9901 date 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barasvlefshme të tij.
Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

ORTAKU I VETEM:

ADI BALLA

ADI BALLA